



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 220 Prot.

Tiranë, më 07. 02. 2018

**V E N D I M**

**Nr. 47, Datë 07. 02. 2018**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa numër 139, datë 27.10.2017, e bërë nga E. P., kundër K. B., me detyrë N/drejtores e Shkollës 9-vjeçare “Gustav Mayer” Tiranë, në të cilën pretendon diskriminim të vajzës<sup>1</sup> së saj, *për shkak aftësisë së kufizuar*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

E. P. sqaron se vajza e saj, e diagnostifikuar me Sindromën Down, është nxënëse në shkollën 9-vjeçare “Gustav Mayer” Tiranë. Prej disa kohësh ajo ndodhet në rrethana dalluese dhe përjashtuese, duke u trajtuar në mënyrë diskriminuese nga ana e N/drejtoreshës së shkollës K. B. Sipas ankueses, K. B. vazhdimisht e vë në qendër të vëmendjes vajzën e saj duke evidentuar se ajo është një fëmijë me aftësi të kufizuara. Kjo situatë ka bërë që vajza të mos ndjehet mirë, duke kërkuar të mos frekuentojë më shkollën, për të mos u përballur me K. B. E ndodhur përpara kësaj situatë, ankuesja i është drejtuar Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë me një ankesë, si dhe shqetësimin e saj ia ka paraqitur edhe Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lindita Nikolla. Sapo K. B. është vënë në dijeni të ankesave të E. P., ka reaguar menjëherë duke i kërkuar sqarime vajzës tjetër<sup>2</sup> të ankueses.

Në këtë situatë, ankuesja ka kërkuar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të merren masa ndaj K. B., duke e larguar nga puna për shkak të sjelljeve të saj.

Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar është një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikohet se: “*Diskriminim*” është çdo

<sup>1</sup> B. P.

<sup>2</sup> Nxënëses E. P., e cila mëson në të njëjtën shkollë

dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".

**Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërmori hapat proceduralë si më poshtë vijojnë :**

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijoi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me anë të shkresës nr. 61 prot., datë 11.01.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë Qytet dhe Shkollës 9-vjeçare "Gustav Mayer", Tiranë, në të cilën kërkoi informacion mbi pretendimet e subjektit ankues.

- Me shkresën nr. 132/1 prot., datë 23.01.2018, Drejtorja Arsimore Rajonale Tiranë, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi, ku ndër të tjera sqaroi se: *"...Me depozitimin e ankesës së E. P., në Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë, mbi pretendimet e saj për trajtim jo të mirë të fëmijës së saj (nxënëse pranë shkollës së arsimit 9-vjeçar "Gustav Mayer", Tiranë), nga ana e nëndrejtoreshës së kësaj shkolle K. B., me shkresën Nr. 3717, datë 24.10.2017, institucioni ynë i është drejtuar shkollës së arsimit 9-vjeçar "Gustav Mayer", Tiranë, që të marrë menjëherë të gjitha masat për shqyrtimin e kësaj ankese në Komisionin e Disiplinës së shkollës. Një veprim i tillë është i diktuar nga përcaktimet e Dispozitave Normative të arsimit parauniversitar, ku është e përcaktuar se masat disiplinore ndaj personelit mësimor si dhe ndaj nëndrejtorëve të shkollës është kompetencë dhe merren nga Komisioni i Disiplinës së shkollës përkatëse. Nga ana e Komisionit të Disiplinës së shkollës është bërë shqyrtimi i ankesës së E. P. dhe në fund është konkluduar me dhënien e masës disiplinore ndaj nëndrejtoreshës së shkollës së arsimit 9-vjeçar "Gustav Mayer", Tiranë, përkatësisht masën disiplinore "Paralajmërim për përjashtim nga puna".*
- Bashkëngjitur informacionit të sipërcituar, Drejtorja Arsimore Rajonale Tiranë, vuri në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kopje të shkresave të mëposhtme:
  - Shkresa e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë me Nr. 3717, datë 24.10.2017, drejtuar shkollës së arsimit 9-vjeçar "Gustav Mayer", Tiranë, në të cilën kërkohet të merren masa për çështjen në fjalë.
  - Shkresa e shkollës së arsimit 9-vjeçar "Gustav Mayer", Tiranë, Nr. 64, datë 07.11.2017, drejtuar Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, në të cilën i

kthehet se pasi Komisioni i Disiplinës shqyrtoi ankesën e E. P., ndaj nëndrejtoreshës K. B. mori masën disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*”.

- Vendimi i Komisionit të Disiplinës Nr. 70 prot., datë 06.11.2017, i shkollës së arsimit 9-vjeçar “Gustav Mayer”, Tiranë, në të cilin evidentohet masa e marrë ndaj nëndrejtoreshës K. B.
- Shkresa e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë me Nr. 4393, datë 19.12.2017, drejtuar shkollës së arsimit 9-vjeçar “Gustav Mayer”, Tiranë, në të cilën kërkohet të merren masa për çështjen në fjalë të publikuar tashmë edhe në media, në emisionin investigativ “STOP”.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

**Për sa më sipër, gjatë procesit të hetimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi dhe palët kundrejt së cilës drejtohej ankimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi :**

Sipas informacionit dhe provave të administruara, konstatohet se nga ana e nëndrejtoreshës së shkollës së arsimit 9-vjeçar “Gustav Mayer”, Tiranë, K. B., ka patur një sjellje diskriminuese dhe shkelje të etikës së komunikimit ndaj nxënëses me aftësi të kufizuara, shtetases B. P. Pasi ankuesja ka bërë prezent në Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë dhe në drejtorinë e shkollës “Gustav Mayer”, situatën e ndodhur ndaj vajzës së saj, nga ana e këtyre institucioneve janë marrë masat, duke mbledhur Komisionin Disiplinore dhe duke marrë masën disiplinore “*Paralajmërim për largim nga puna*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga ana e E. P., Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se situata e pretenduar nga ankuesja është zgjidhur dhe nuk ekziston më.

Për sa më sipër, gjykojmë dhe vlerësojmë se kërkesa e E. P., është plotësuar dhe është arritur qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, gërma “c”, nenit 33, pika 10, e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 139, datë 27.10.2017, të E. P., kundër K. B., me detyrë N/drejtores e Shkollës 9-vjeçare “Gustav Mayer” Tiranë, pasi është arritur qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkollës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**KOMISIONERI**

---

**Irma BARAKU**

(Shkaku: Aftësi e kufizuar)

(Fusha: Arsim)